



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor**  
**Prokuroria Themelore Prishtinë / Osnovno Tužilaštvo Prishtina / Prishtina Basic**  
**Prosecution**  
**Autoriteti Kompetent / Kryeprokurori**

---

AD.nr.12/2024

Datë: 20.08.2024

Autoriteti Kompetent, duke vendosur lidhur me ankesën disiplinore të parashtruar nga ana e palës ankuese F [REDACTED] K [REDACTED], ndaj D [REDACTED] H [REDACTED], Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, në bazë të nenit 9, paragrafi 1, pika 1.5 dhe paragrafi 6, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, me datë 20.08.2024 merr këtë:

**V E N D I M**

Refuzohet ankesa kundër D [REDACTED] H [REDACTED], Prokurore në Prokurorinë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, pasi që duke u bazuar në nenin 6, par. 2, pika 2.2, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, veprimet e prokurores nuk paraqesin shkelje disiplinore.

**Arsyetim**

Me datë 26.07.2024, Kryeprokurori, duke qenë në cilësinë e Autoritetit Kompetent, ka pranuar ankesën disiplinore nga ana e palës ankuese F [REDACTED] K [REDACTED] i cili ka cilësinë e palës së pandehur në lëndën penale PP.I.nr. [REDACTED] ndaj prokurores D [REDACTED] H [REDACTED] e cila ka qenë në trajtim të kësaj lënde penale, me pretendimet se prokurorja e lartcekur ka pasur qasje të gabuar, tendencioze dhe jo profesionale gjatë trajtimit dhe vendosjes lidhur me këtë çështje penale duke vë në rrezik sigurinë juridike të qytetarëve, me ç'rast palës ankuese i kishte shkaktuar dëme në punë dhe avancimin e tij,

me pretendimet se veprimet e prokurores D [REDACTED] H [REDACTED] kanë rënë ndesh me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent, pas analizimit dhe trajtimit të detajuar të kësaj çështje, konsideron se pretendimet e ngritura ankimore nuk paraqesin bazë të mjaftueshme dhe të arsyeshme për të rekomanduar fillimin e procedurës disiplinore ndaj Prokurores D [REDACTED] H [REDACTED]

#### **Veprimet e Autoritetit Kompetent:**

- Me datë 26.07.2024, Autoriteti Kompetent ka regjistruar ankesën disiplinore me numër AD.nr.12/2024.
- Me datë 30.07.2024, Autoriteti Kompetent ka njoftuar Kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, përmes Letër Informimit, për pranimit e ankesës.

#### **Të gjeturat e Autoritetit Kompetent:**

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda, me datën 15.01.2023 ka pranuar kallëzimin penal nga Policia e Kosovës NJHP- Prishtinë, me nr. të rastit [REDACTED] e dt. 15.01.2023, kundër të pandehurit F [REDACTED] K [REDACTED], për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (tutje KPRK) dhe veprën penale Mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rëna ka zhvilluar hetimet kundër të pandehurit F [REDACTED] K [REDACTED] për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armeve nga neni 366 par.1 të KPRK-së. Me datë 19.01.2023, prokurorja D [REDACTED] H [REDACTED] ka lëshuar urdhëresë për tërheqjen e video-incizimeve të kamerave të vendosura përreth vendit të ngjarjes, me qëllim që të ndihmojë në zbardhjen e kësaj çështje penale. Me datë 06.02.2023, është pranuar Raporti preliminar analitik mbi analizimin e video-incizimeve me rastin [REDACTED], nga ku shihet përleshja fizike mes të pandehurit F [REDACTED] K [REDACTED] dhe të dëmtuarit G [REDACTED] B [REDACTED], ku dyshohet se i pandehuri F [REDACTED] K [REDACTED] e ka sulmuar me mjet të mprehtë-thikë të dëmtuarin G [REDACTED] B [REDACTED]. Me datë 01.02.2023 është pranuar Akt ekspertimi mjeko-ligjor për të dëmtuarin G [REDACTED] B [REDACTED] me çka janë konstatuar plagë prerëse shpuese në regjionin i jor, në regjionin e shpinës pranë boshtit kurrizor majtas, në bërrylin e dorës së majtë, në kofshën e majtë, në regjionin nën shpatullën e majtë, dëmtime këto të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë dhe me majë e të cilat bëjnë pjesë në Dëmtime të lehta trupore.

Me datë 15.01.2023, prokurorja e çështjes ka bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit kundër të pandehurit F [REDACTED] K [REDACTED] me konstatimin se janë plotësuar kushtet ligjore që ndaj të njëjtit të caktohet masa e paraburgimit. Me datë 17.01.2023, Gjykata Themelore Prishtinë përmes Aktvendimit PPRKR.nr.11/23 të datës 16.01.2023, ka aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit F [REDACTED] K [REDACTED] në kohëzgjatje prej një (1) muaj. Me datë 10.02.2023, prokurorja e çështjes pranë gjykatës kompetente ka parashtruar kërkesën për vazhdimin e masës së paraburgimit kundër të pandehurit F [REDACTED] K [REDACTED] edhe për dy (2) muaj të tjerë. Me datë 20.02.2023 kemi pranuar Aktvendimin PPRKR.nr.11/2023 të dt.14.02.2023, përmes së cilës Gjykata kishte refuzuar kërkesën për caktim të paraburgimit ashtu

që ndaj të pandehurit F. K. ishte caktuar masa e arrestit shtëpiak, ndaj të cilit vendim prokurorja e çështjes me datë 21.02.2023 ka ushtruar ankesë, e po ashtu ankesë ka ushtruar edhe mbrojtësi i të pandehurit F. K. ankesa këto të cilat ishin refuzuar me aktvendimin PN.1.nr.176/2023 të datës 28.02.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës, ndërkaq aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PPRKR.nr.11/23 i dt.14.02.2024, ishte vërtetuar.

Gjatë fazës hetimore, prokurorja e çështjes me datë 19.01.2023 kishte marrë në pyetje të dëmtuarin G. B. me datë 27.01.2023 kishte marrë në pyetje të pandehurin F. K. me datë 09.02.2023 kishte marrë në pyetje dëshmitaren [redacted] si dhe me datë 14.02.2023 kishte marrë në pyetje dëshmitaren [redacted] dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve hetimore, me datë 09.03.2023, brenda afatit ligjor kishte ngritur aktakuzën PP. [redacted] kundër të pandehurit F. K., me dyshimin e bazuar mirë se i njëjti ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë, nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas aktakuzës së paraqitur nga Prokurori i Shtetit, me datë 29.03.2023 ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku i pandehuri është deklaruar i pafajshëm, me datë 23.10.2023 mbrojtësi i të pandehurit F. K., av.H. [redacted] pranë Gjykatës ka paraqitur kërkesë për hudhje të aktakuzës me pretendimet se veprimet e të mbrojturit të tij nuk paraqesin vepër penale, kërkesë kjo e cila ishte shqyrtuar nga Gjykata dhe ishte refuzuar me Aktvendimin PKR.nr.134/23 të dt.20.11.2023.

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, administrimit të provave dhe fjalës përfundimtare, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 15.03.2024 ka marrë Aktgjykimin PKR.nr.134/23, ashtu që të akuzuarin F. K. e kishte liruar nga akuza për veprën penale Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, sepse ka rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale, përkatësisht veprimet e të pandehurit janë në kuadër të mbrojtjes së nevojshme, e po ashtu edhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së i akuzuari F. K. është liruar nga akuza, meqë vepra penale për të cilën është akuzuar nuk përbën vepër penale. Kundër Aktgjykimin PKR.nr.134/23 të dt.11.04.2024, prokurorja e çështjes kishte ushtruar ankesë për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të shkeljes së ligjit penal. Me datë 11.06.2024, Gjykata e Apelit të Kosovës, përmes Aktgjykimin PAKR.nr.252/2024 kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, ndërkaq aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.134/2023 të dt.11.04.2024 e kishte vërtetuar.

Duke analizuar rastin, po ashtu rrjedhën e veprimeve të ndërmarra nga Prokurorja D. H. Autoriteti Kompetent vlerëson se veprimet e saj nuk përbëjnë shkelje disiplinore të cilat janë të parapara në mënyrë shprehimore me Ligjin Nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

#### Veprimet e ndërmarra pas hapjes së rastit

- Marrja e raportit me shkrim nga ana e prokurores D. H. lidhur me pretendimet ankimore.
- Shqyrtimi i shkresave të lëndës penale PP. [redacted]

### Deklarimet e palës ankuese

Me datë 26.07.2024, pala ankuese F. K. i cili në lëndën penale PP. kishte cilësinë e palës së pandehur, kemi pranuar ankesën disiplinore kundër prokurores D. H. ku ankuesi ndër të tjera pretendon se prokurorja e lartcekur, gjatë trajtimit dhe vendosjes lidhur me lëndën në fjalë ka treguar qasje të gabuar, tendencioze dhe joprofesionale, për shkak të paditurisë elementare të një Prokurore të Shtetit, duke vënë në rrezik sigurinë juridike të qytetarëve, duke i shkaktuar dëm të pariparueshëm në punë dhe avancimin e tij. I njëjti në ankesën e tij po ashtu thekson se prokurorja D. H. kishte ushtruar ankesë kundër vendimit të gjykatës për refuzimin e kërkesës së prokurores lidhur me caktimin e paraburgimit, duke mos marrë parasysh faktin se pala e pandehur ishte vetdorëzuar, duke mos marrë parasysh faktin se pala e dëmtuar me vetiniciativë nënshkruan një pajtim familjar me prindin e të pandehurit, duke mos marrë parasysh as faktin se i pandehuri është ushtar aktiv i Forcës së Sigurisë së Kosovës, e po ashtu këto rrethana nuk i merr parasysh as kur ushtron ankesë ndaj aktvendimit me të cilin gjykata i ka ndërprerë masën e arrestit shtëpiak, me pretendimet se prokurorja D. H. e ka dashur caktimin e arrestit shtëpiak për një ushtar aktiv të FSK-së, e ka dashur humbjen e punës së tij, edhe përkundër faktit se i pandehuri nuk e ka shkelur për asnjë moment masën e cila i ishte caktuar nga gjykata. Pala ankuese tutje thekson se prokurorja D. H. për të ndërtuar një aktakuzë të pambështetur, besimin ia ka falë deklaratave të dëshmitareve dhe cilat deklaratata janë të rreme dhe nuk përkojnë me realitetin, ashtu që me datë 09.03.2023 prokurorja D. H. ngrit një aktakuzë të pambështetur në asnjë provë, apo siç e specifikon ankuesi "Aktakuzë Qyqe", ku të pandehurin F. K. e akuzon për veprën penale Vrasje në tentativë, ndërkaq në ankesë kundër aktgjykimit lirues e rëndon pak duke e akuzuar për veprën penale Vrasje e rëndë në tentativë. Pala ankuese në ankesën e tij kërkon që prokurorja D. H. të largohet menjëherë nga pozita e saj si Prokurore e Shtetit, meqenëse e njëjta në trajtimin e kësaj çështje penale nuk ka treguar profesionalitet.

### Deklarimet e Prokurores D. H. në raportin e saj me shkrim të dt. 06.08.2024

Prokurorja D. H. në raportin e saj të dhënë me shkrim me datë 06.08.2024, ndër të tjera ka deklaruar se: Duke vepruar në bazë të kërkesës së juaj AD.NR. 12/2024, të datës 30.07.2024 të cilën kërkesë e kam pranuar me dt. 30.07.2023, ku keni kërkuar raport me shkrim lidhur me lëndën PP. Unë lëndën PP. e kam pranuar në punë me dt. 15.01.2023. Lidhur me lëndën PP. me qellim të ndriçimit të kësaj çështje kemi nxjerrë Aktvendim për fillimin e hetimit kundër të pandehurit F. K. për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së. Ndaj të pandehurit F. K. kemi bërë kërkesë për caktimin e paraburgimit PP. me datë 15.01.2023 për shkak të ekzistimit të dyshimit të bazuar se i pandehuri F. K. ka kryer veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së. Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda — Gjyqtari i Procedurës Paraprake me Aktvendimin PPRKR 11/23 me datë 16.01.2023 e ka aprovuar Kërkesën e Prokurores Themelore në Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PP. të dt. 15.01.2023 për caktimin e masës së paraburgimit ndaj të pandehurit F.

K███ Prokurori i çështjes në këtë rast unë kam bere Urdhërese për ekspertizë mjeko ligjore, ku nga ekspertiza mjeko-ligjore e përpiluar nga eksperti mjeko ligjor Dr. ██████ dt. 31.01.2023 është konstatuar se të dëmtuarit G███ B███ i janë shkaktuar plagë prerëse, shpuese në regjionin e majtë i jor, në regjionin e shpinës pranë boshtit kurrizor majtas, në bërrylin e dorës së majtë, në kofshën e majtë, në regjionin nën shpatullën e majtë të cilat janë shkaktuar nga veprimi mekanik i mjetit të mprehtë dhe maje. Po ashtu janë marrë veprime tjera procedurale siç janë: Marrja në pyetje e të dëmtuarit-dëshmitarit G███ B███ në Prokurori me datë 19.01.2023, Marrja në pyetje e dëshmitares ██████ dt. 09.02.2023 në Prokurori, Marrja në pyetje e të pandehurit F███ K███ dt. 14.02.2023 në Prokurori, Marrja në pyetje e të pandehurit F███ K███ dt. 27.01.2023, në të cilat veprime të Prokurorisë asnjëra nga palët e lartcekura nuk kanë paraqitur ndonjë vërejtje në procesverbalet e mbajtura dhe i kanë nënshkruar pa vërejtje. Në deklaratën e të pandehurit F███ K███ të dhënë në polici në prani të avokatit mbrojtës av. H███ J███ i pandehuri i lartcekur F███ K███ ka pranuar që ka pasur brisk me vete dhe te briskun e ka përdorur ashtu që e ka goditur disa herë të dëmtuarin e lartcekur dhe pastaj pas ngjarjes e ka hudhur briskun rrugës dikund. Po ashtu faktin se e ka goditurin të dëmtuarin e ka pranuar edhe në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori me datë 27.01.2023. I pandehuri F███ K███ i cili është marrë në pyetje në prezencë e avokatit mbrojtës A███ K███ nuk ka pasur vërejtje, dhe të njëjtit procesverbalin e kanë nënshkruar pa asnjë vërejtje. Po ashtu edhe i dëmtuari-dëshmitari G███ B███ në polici por edhe në Prokurori ka deklaruar ndër të tjera se është goditur me thikë disa herë në vendet e përshkuar si në ekspertizë mjekoligjor dhe goditje me thikë i janë shkaktuar nga i pandehuri i lartcekur F███ K███. Për më tepër i dëmtuari-dëshmitari G███ B███ ka deklaruar se babai i të pandehurit F███ K███ i cili quhet H███ K███ i ka kërkuar falje për veprimet e të pandehurit F███ K███ ndaj të dëmtuarit G███ B███. Po ashtu kemi marrë edhe veprime tjera procedurale dhe pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha fakteve dhe provave të siguruara gjatë hetimit kemi ardhur në përfundim se ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri F███ K███ ka kryer veprat penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe për veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së dhe kemi ngritur aktakuzë PP.███ me datë 09.03.2023 kundër të pandehurit F███ K███ për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe për veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së. Nga i pandehuri F███ K███ dhe as nga mbrojtësit e tij gjatë tërë kësaj çështje penale duke përfshirë Procedurën Penale në Prokurori dhe fazën e shqyrtimit gjyqësor nuk ka pasur kërkesë nga cilado palë në këtë çështje penale për përjashtim tim si Prokuror i çështjes dhe po ashtu as nga ana ime nuk ka ekzistuar dhe nuk ekziston ndonjë arsye apo çfarëdo rrethanë ekzistimi i të cilës do të përbente shkak për kërkimin e përjashtimit tim nga trajtimi i kësaj çështje penale. Nga avokati H███ I███ mbrojtësi i pandehurit F███ K███ kemi pranuar kërkesë për negocimin e marrëveshjes për pranimin të fajësisë, pas të cilës pas konsultimit me Kryeprokurorin z. K███ M███ me datë nuk kemi hyrë në negocimin e marrëveshje për pranim të fajësisë për shkak se mbrojtja e të pandehurit nuk është pajtuar me cilësimin juridik të veprës penale. Lidhur me këtë çështje penale është zhvilluar procedura penale në Gjykatën Themelore Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Departamentit për Krime të Rënda PP.I.nr. ██████ dt. 09.03.2023 ndaj të pandehurit F███ K███ për veprat penale të lartcekura, ku Gjykata Themelore Prishtinë — Departamenti për Krime të Rënda me Aktvendimin PKR.nr. 134/23 dt. 20.11.2023 e ka refuzuar kërkesën për hedhje të aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prishtinë — Departamentit për Krime të Rënda PP.███ dt. 09.03.2023 ndaj të pandehurit F███ K███ për veprën penale Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së

dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par 1 të KPRK-së dhe pas kësaj është caktuar dhe janë mbajtur shqyrtimet gjyqësore. Prokurori i Shtetit në këtë rast unë si Prokuror e çështjes kam qëndruar pranë Aktakuzës gjatë gjithë procedurës penale edhe në fjalën përfundimtare. Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me datën 11.04.2024 ka nxjerrë Aktgjykim Lirues PKR.nr.134/23 ndaj të pandehurit F. K. Ndaj Aktgjykimit Lirues kemi paraqitur Ankesë PP.I. nr. të datës 19.04.2024. Gjykata e Apelit të Kosovës me Aktgjykimin PAKR.nr 252/2024 të dt. 11.06.2024 ka vërtetuar Aktgjykimi e Gjykatës Themelore Prishtinë- Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr 134/23 i dt. 11.04.2024. Andaj duke u bazuar në këto që u thanë më lartë asnjë nga pretendimet e paraqitura nga i pandehuri F. K. në Ankesën e tij lidhur me këtë çështje penale ndaj meje si Prokuror i Çështjes nuk qëndrojnë dhe janë plotësisht të pabazuara.

## KONKLUDIM

Në cilësinë e Autoritetit Kompetent, konsiderojmë se veprimet e prokurores D. H. gjatë trajtimit të kësaj çështje penale kanë qenë në kuadër të autorizimeve të saj ligjore dhe kushtetuese. Kodi nr. 08/l-032 i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës (tutje KPPRK), neni 234, paragrafi 1 ka paraparë se “Pas përfundimit të hetimit ose kur prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat ai disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer vepër penale apo vepra penale, procedura para gjykatës mund të zbatohet vetëm në bazë të aktakuzës së ngritur nga prokurori i shtetit”. Në rastin konkret, prokurorja D. H. kundër së cilës është paraqitur kjo ankesë disiplinore, ka vlerësuar se në çështjen penale ndaj të pandehurit F. K. të evidentuar nën shenjën PP. ekziston dyshimi i bazuar mirë se i lartcekuri ka kryer veprën penale Vrasja në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, si dhe veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, andaj me datë 09.03.2023 ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit F. K. duke e dërguar çështjen pranë gjykatës kompetente. Në këtë drejtim, është në diskrecionin e prokurorit të çështjes që pas vlerësimit të provave dhe informacioneve me të cilat posedon, të vendosë nëse duhen pushuar hetimet në një çështje penale apo duhet ngritur aktakuzë. Për më tepër, Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP. ishte konfirmuar nga kryetari i trupit gjykues, pasi që me Aktvendimin PKR.nr.134/23 të dt.20.11.2023 ishte refuzuar kërkesa për hedhje të aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i të akuzuarit F. K.

Fakti se prokurorja e çështjes D. H. ka parashtruar ankesë ndaj vendimeve të gjykatës për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale, edhe kjo vendim marrje hyn në diskrecionin e prokurorit të çështjes. Prokurori i çështjes, në këtë rast prokurorja D. H. ka qenë e lirë të vlerësojë nëse duhet parashtruar ankesë apo jo, në kuptim të nenit 411 paragrafi 1 i cili përcakton se “Ankesa kundër aktvendimit ose urdhrit mund të paraqitet nga ana e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, të dëmtuarit ose viktimës, mbrojtësit të viktimave ose përfaqësuesit të viktimës dhe nga secili person i cili është i përfshirë në aktvendim ose urdhër”. Andaj, ligjvënësi ka përcaktuar qartë mundësitë që prokurori i shtetit MUND të paraqesë ankesë kundër aktvendimeve të gjykatës, gjë të cilën e ka bërë edhe prokurorja D. H.

Fakti që prokurorja e çështjes ka rënduar veprën penale për të pandehurin me ankesën ndaj aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.134/23 të dt.11.04.2024, të parashtruar me dt.19.04.2024, ashtu që në vend të Vrasjes në tentativë ka cekur

Vrasjen e rëndë në tentativë, theksojmë se ky është një gabim teknik dhe i paqëllimshëm i prokurores së çështjes meqenëse edhe pse e njëjta ka cekur vrasjen e rëndë në tentativë, bazën ligjore nuk e ka ndryshuar, duke u thirre në nenin 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, e cila korrespondon në Vrasje në tentativë e jo në Vrasje të rëndë në tentativë.

Sa i përket pretendimit të palës ankuese për paaftësinë profesionale të prokurores D. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] pretendimeve për mungesë të njohurive elementare të prokurores në fjalë dhe faktit se aktakuza e saj ka rënë në gjykatë, theksojmë se Këshilli Prokurorial i Kosovës ka mekanizma brenda saj dhe komisione përkatëse të cilat vlerësojnë në baza periodike performancën e prokurorëve, përfshirë edhe performancën e këtu prokurores D. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] andaj në këtë drejtim, edhe trajtimi i kësaj lënde penale nga ana e prokurores D. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] dhe fakti se e njëjta ka përfunduar me aktgjykim lirues, gjithsesi që këto do të merren parasysh gjatë vlerësimit të performancës së prokurores në fjalë.

Sa i përket faktit të theksuar nga ankuesi F. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR], se i njëjti është anëtar i Forcave të Sigurisë së Kosovës, kjo rrethanë nuk i jep imunitet të njëjtit nga veprimet inkriminuese të cilat mund t'i ketë kryer dhe nuk paraqet pengesë për organin e ndjekjes në zhvillimin e procedurës penale ndaj tij.

Sidoqoftë, në cilësinë e Autoritetit Kompetent për vlerësimin e performancës së prokurorëve të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, prokurori kjo me të cilën udhëheqë, çdo lëshim i paqëllimshëm nga ana e prokurorëve dhe çdo ankesë në drejtim të tyre, e që nuk përbën shkelje disiplinore, përfshirë edhe rastin konkret, të njëjtat do të vendosen në dosjen e prokurorit konkret dhe do të merren parasysh gjatë procesit të vlerësimit të performancës vjetore të tyre, përfshirë këtu edhe vlerësimin e performancës së prokurores D. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] apo shqyrtimin e mundësive të inicimit të vlerësimit jo të rregullt të prokurores në fjalë.


Në kontekst të veprimeve të lartpërmendura, si Autoritet Kompetent, vlerësoj se nuk është provuar se Prokurorja D. [REDAKTUAR] H. [REDAKTUAR] është përfshirë në veprime të cilat do të binin ndesh me dispozitat e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga krejt çka u konstatuar më lartë, kemi gjetur se nuk qëndrojnë pretendimet e deklaruara në këtë ankesë disiplinore, ngase në asnjë rast NUK është vërtetuar që veprimet e prokurores paraqesin shkelje disiplinore në bazë të nenit 6, par. 2 pika 2.2 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Në kuptim të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, ankesën disiplinore e REFUZOJMË SI TË PABAZUAR.

Me sa u cek më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**AUTORITETI KOMPETENT KRYEPROKURORI**



**Vendimi i dërgohet:**

- Këshillit Prokurorial të Kosovës
- Arkivës